



**FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT**

Shtojca 12.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET
E ANKIMIMIT**

Data: 15/09/2026

Drejtuar: BOE: "2 N" sh.p.k NIPT - L31615017L, adresa: Kamez Paskuqan, Rr. Demokracia, Nr. pasurie 46/6-N15, Zona kadastrale 2884, Paskuqan, Kamëz & "Shendelli" sh.p.k NIPT-K07924803N, adresa: Fier, Lagjja "Kastrioti", Rr. "Andon Profka", 2 kullat Fier.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ JO ☐

OE: "A.SH. Engineering" sh.p.k NIPT-L31617003F, adresa: Rruga "Grigor Gjirokastriti", ish Fusha e Aviacionit, Ndërtesa 12, Kati i Parë, Njësia Administrative Nr.7, Tiranë.

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

* * *

Tipi i kontratës: "Punë"

Lloji i procedurës: "E hapur".

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-95454-08-05-2026.

Përshkrim i shkurtër i kontratës/marreveshjes kuader: "Investime për ngritjen e produkteve turistike në zonat e reja me potencial zhvillimi rajonal dhe lokal, boot camp, resorte eco, kampingje, ski resort, etj: Zona e Eco Park Dumrea në Belsh – Pasurim me funksione të reja , 'Park Social Edukativ dhe Kulturor në funksion të fëmijëve' Eco Park Dumrea – Belsh". Kontratë me çelësa në dorë." Kohëzgjatja e kontratës: 20 muaj. Fondi limit: 333,143,073.47 lekë pa TVSH.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 06.08.2026.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike datë: [10.08.2026] [Numri 51].

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☒
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

* * *

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. OE: "2 N" sh.p.k NIPT - L31615017L & "Shendelli" sh.p.k NIPT-K07924803N, vlera 217,558,760.00 lekë pa tvsh. Totali i pikëve 250.35

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ JO ☐

OE "A.SH. Engineering" sh.p.k NIPT-L31617003F, adresa: Rruga "Grigor Gjirokastriti", ish Fusha e Aviacionit, Ndërtesa 12, Kati i Parë, Njësia Administrative Nr.7, Tiranë

2. OE: "HASTOÇI" sh.p.k NIPT - J62028009B, vlera 228,241,995.88 lekë pa tvsh. Totali i pikëve 246.75

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. BOE: "B93 II" sh.p.k NIPT - L52209050O & "ASI-2A CO" sh.p.k NIPT - K53002402C, vlera 256,154,593.51 lekë pa tvsh. Totali i pikëve 238.20

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. BOE: "NIKA" sh.p.k - J76705047U & "MANE/S" shpk - J64103865K, vlera 251,605,315.90 lekë pa tvsh. Totali i pikëve 230.40

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. BOE: "ERGI" sh.p.k NIPT - K02727229P & "T & XH" sh.p.k NIPT - L72121504I, vlera 295,810,754.35 lekë pa tvsh. Totali i pikëve 226.35

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. BOE: "S I R E T A 2F" sh.p.k NIPT - K51501008J & "AGRI CONSTRUCTION" sh.p.k NIPT - K01725001F, vlera 248,994,469.00 lekë pa tvsh. Totali i pikëve 224.25

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

7. OE: "BE - IS SH.P.K - K71412003A, vlera 281,594,357.00 lekë pa tvsh. Totali i pikëve 215.25

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

8. OE: "AGI KONS" sh.p.k NIPT - K21622001M, vlera 302,664,128.86 lekë pa tvsh. Totali i pikëve 196.05

PO ☐ JO ☒ X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

9. BOE: “VELLEZERIT HYSA” sh.p.k NIPT - K12911201C & “ZENIT&CO” - K61731002D, vlera 235,177,862.32 lekë pa tvsh. Totali i pikëve_Skualifikuar.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒ X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

10. BOE: “G.P.G. COMPANY” sh.p.k NIPT - J64324443V & “InfraKonsult” sh.p.k NIPT- L21512022F, vlera 206,548,706.00 lekë pa tvsh. Totali i pikëve_Skualifikuar.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒ X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

11. BOE: “NEWGEN” sh.p.k NIPT - L92014008U & “INERTI” sh.p.k NIPT - J66926804L, vlera 242,648,415.00 lekë pa tvsh. Totali i pikëve_Skualifikuar.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒ X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

12. BOE: “RSM COMPANY” - 810802422 & “AURORA KONSTRUKSION” sh.p.k NIPT - K02017003I, vlera 251,694,945.00 lekë pa tvsh. Totali i pikëve_Skualifikuar

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒ X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE.: “VELLEZERIT HYSA” sh.p.k. & “ZENIT & CO” sh.p.k. nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në pikat 2.3.3, 2.3.4 dhe 2.3.6 të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit.

Nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezulton se personeli kryesor dhe një pjesë e konsiderueshme e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive të deklaruara për përmbushjen e kapaciteteve minimale të kërkuara në këtë procedurë janë të angazhuar njëkohësisht edhe në Marreveshjen Kuader me objekt “Ndërhyrje për përmirësimin e sigurisë, qendrueshmërisë dhe funksionalitetit të rrugëve”, në të cilën operatori ekonomik është kontraktuar. Nga krahasimi i dokumentacionit rezultojnë të njëjtët specialistë dhe të njëjtat mjete të identifikuar me të njëjtat të dhëna individualizuese (targa, numra shasje, kontrata qiraje etj.).

Po ashtu, në seksionin “Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata të Tjera”, operatori ekonomik ka deklaruar nën përgjegjësi se mjetet, pajisjet, makineritë dhe stafi teknik i deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata apo punëmarrje të tjera publike që bien ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit dhe se do të angazhohen vetëm për realizimin e objektit të kontratës.

Në këto kushte, deklarimi  **FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT** paralel i të njëjtave kapacitete njerëzore dhe teknike për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit në dy procedura të ndryshme prokurimi vë në dyshim disponueshmërinë efektive

dhe ekskluzive të tyre për realizimin e kontratës objekt prokurimi dhe bie në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikat 2.3.3, 2.3.4 dhe 2.3.6 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, si dhe me vetë deklarimin e operatorit ekonomik mbi mosangazhimin e këtyre kapaciteteve në kontrata të tjera.

Për rrjedhojë, oferta e B.O.E.: “VELLEZERIT HYSA” sh.p.k. & “ZENIT & CO” sh.p.k., skualifikohet për mosplotësim të kriterëve të kapacitetit teknik dhe disponueshmërisë së personelit, mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara nga Dokumentet Standarde të Tenderit.

2. BOE “GPG COMPANY” sh.p.k. & “InfraKonsult” sh.p.k. skualifikohet, pasi oferta ekonomike e paraqitur nuk përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 4.4, kriteri nr. 5, “Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)”, të Dokumenteve të Tenderit.

Sipas këtij kriteri, ofertuesi duhet të ofertojë për zërin “Siguria në kantier – PSK” një vlerë jo më të vogël se 8,863,863.64 lekë pa TVSH. Dokumentet e Tenderit përcaktojnë shprehimisht se ofertuesi nuk duhet ta plotësojë formularin e ofertës nën këtë vlerë minimale.

Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike rezulton se BOE-ja ka ofertuar për zërin PSK vlerën 5,257,905 lekë pa TVSH, e cila është 3,605,958.64 lekë, ose rreth 40.68%, më e ulët se minimumi i detyrueshëm i përcaktuar në Dokumentet e Tenderit.

Kjo mangësi nuk mund të korrigjohet nëpërmjet kërkesës për sqarim, pasi rritja e vlerës së PSK-së pas hapjes së ofertave do të përbënte ndryshim të një elementi të ofertës ekonomike dhe plotësim të saj pas përfundimit të afatit të dorëzimit.

Për rrjedhojë, oferta ekonomike nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 4.4, kriteri nr. 5, të Dokumenteve të Tenderit dhe refuzohet. BOE “GPG COMPANY” sh.p.k. & “InfraKonsult” sh.p.k. skualifikohet.

3. BOE “NEWGEN” sh.p.k. & “INERTI” sh.p.k. skualifikohet, pasi oferta ekonomike e paraqitur nuk është hartuar në përputhje me formularin e preventivit pa çmime të publikuar nga Autoriteti Kontraktor në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Nga krahasimi i preventivit të publikuar në SPE me preventivin e ofertuar rezulton se BOE-ja nuk ka ofertuar për zërin “Vlera e projektimit sipas VKM nr. 354 për fazat V dhe VI”. Në ofertën ekonomike mungojnë si vlera e projektimit pa TVSH, ashtu edhe vlera përkatëse me TVSH, ndërsa totali përfundimtar është përllogaritur pa përfshirjen e këtij zëri.

Dokumentet e Tenderit përcaktojnë se të gjithë zërat e formularit të listës së çmimeve duhet të plotësohen dhe t’u vendoset çmimi përkatës, ndërsa zërat pa vlerë konsiderohen zëra të paofertuar dhe sjellin refuzimin e ofertës.

Mungesa nuk mund të plotësohet nëpërmjet një kërkesë për sqarim, pasi vendosja e çmimit të projektimit pas hapjes së ofertave do të përbënte plotësim dhe ndryshim material të ofertës ekonomike, duke ndryshuar njëkohësisht edhe vlerën e saj përfundimtare.

Për rrjedhojë, oferta



konsiderohet e paplotë dhe jo në përputhje me kërkesat e Dokumenteve të Tenderit dhe BOE “NEWGEN” sh.p.k. & “INERTI” sh.p.k. skualifikohet.

4. B.O.E “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h L04803001U “RSM COMPANY” shpk (mëma) Nr Biznesi 810802422 & “AURORA KONSTRUKSION” sh.p.k K02017003I

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë BOE “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h., degë e shoqërisë së huaj “RSM COMPANY” SHPK, & “AURORA KONSTRUKSION” sh.p.k., **nuk përmbush kriterin e kapacitetit teknik** të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, lidhur me përvojën e suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme për objektin: “INVESTIME PËR NGRITJEN E PRODUKTEVE TURISTIKE NË ZONAT E REJA ME POTENCIAL ZHVILLIMI RAJONAL DHE LOKAL, BOOT CAMP, RESORTE ECO, KAMPINGJE, SKI RESORT, ETJ: ZONA E ECO PARK DUMREA NË BELSH – PASURIM ME FUNKSIONE TË REJA, ‘PARK SOCIAL EDUKATIV DHE KULTUROR NË FUNKSION TË FËMIJËVE’ ECO PARK DUMREA – BELSH”.

Sipas pikës 2.3.1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, operatori ekonomik duhet të dëshmojë përvojë të ngjashme duke përmbushur njërin nga kushtet e mëposhtme:

a) të ketë realizuar një kontratë të vetme me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës objekt prokurimi; ose

b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shënim: OE/BOE, për punët e ngjashme të realizuara që shtrihen pjesërisht brenda periudhës 5 (pesë) vjeçare, duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës provues që vërteton qartë pjesën e punimeve të realizuara brenda kësaj periudhe, si dhe vlerën monetare të punimeve të ekzekutuara gjatë saj.

Konkretisht, operatori ekonomik “AURORA KONSTRUKSION” sh.p.k, anetar i këtij bashkimi me 53.31%, nuk plotëson kriterin e punëve të ngjashme sipas kushtit a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (në vlerën 166,571,537 lekë pa TVSH) dhe as kushtin b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (në vlerën 355,197,145 lekë pa TVSH referuar % se pjesëmarrjes).

Gjithashtu, operatori ekonomik “Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë BOE “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h., degë e shoqërisë së huaj “RSM COMPANY” SHPK, & “AURORA KONSTRUKSION” sh.p.k, anëtar dhe njëkohësisht lider i këtij bashkimi, me përqindje pjesëmarrjeje 46.69%, nuk plotëson kriterin e punëve të ngjashme sipas kushtit a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (në vlerën 77,772,251 lekë pa TVSH referuar % se pjesëmarrjes) dhe as kushtin b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale

e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (në vlerën 311,089,002 lekë pa TVSH referuar % se pjesëmarrjes).

Referuar përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik dhe dokumenteve të tenderit, si dhe konceptit të përgjithshëm të prokurimeve, objektet/kontratat e ngjashme, operatorët ekonomik duhet të përmbushin këto elemente:

Elementi Kohë: Kontratat duhet të jenë përfunduar brenda pesë viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

- Elementi Vlerë: Madhësia e kontratave duhet të përmbushë kërkesën e autoritetit kontraktor, qoftë 50% apo 200% të vlerës së kontratës që prokurohet.

- Elementi Natyrë e Ngjashme: Kontratat duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet.

Përmbushja e këtyre kritereve është e domosdoshme për të konsideruar përvojën e një operatori ekonomik si të vlefshme. Mungesa e përmbushjes së një prej këtyre elementëve (kohë, vlerë, natyrë e ngjashme) e bën të pavlefshme përvojën e paraqitur nga kandidatët ofertues.

Sa më sipër, Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë BOE "R|S|M CONSTRUCTION" d.sh.h, degë e shoqërisë së huaj "RSM COMPANY" SHPK, & "AURORA KONSTRUKSION" sh.p.k, skualifikohet nga kjo procedure.

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si ofertues i sukseshëm: BOE: "2 N" sh.p.k NIPT - L31615017L, adresa: Kamez Paskuqan, Rr. Demokracia, Nr. pasurie 46/6-N15, Zona kadastrale 2884, Paskuqan, Kamëz & "Shendelli" sh.p.k NIPT-K07924803N, adresa: Fier, Lagjja "Kastrioti", Rr. "Andon Profka", 2 kullat Fier.

Vlera 217,558,760.00 lekë pa tvsh. Totali i pikëve 250.35.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ JO ☐

-OE: "A.SH. Engineering" sh.p.k NIPT-L31617003F, adresa: Rruga "Grigor Gjirokastriti", ish Fusha e Aviacionit, Ndërtesa 12, Kati i Parë, Njësia Administrative Nr.7, Tiranë.

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik."

